

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit Ndërmarrja N. PX Kosovë sh.p.k me seli në P.,ndaj të të paditurëve; N.H.T H.&R. C. me seli në fshatin H. e Q. me pronare I. K.,në praninë e të të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse (të të autorizuarës me shkrim E. B. e cila e përfaqësoj palën paditëse dhe përfaqesues së përkohshme avokates T. Zh. e cila e përfaqësoj palën e paditur ),lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej;2.781,23 euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;26.02.2016,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar me shkrim nga palët ndërgjyqëse,me datën;08.03.2016 merr këtë:

### A K T V E N D I M

Shfuqizohet aktvendimi për lejimin e përmbarimit E.nr.1011/2012 i datës;31.12.2012 pas kundërshtimit të palës debitore të ushtruar ndaj propozimit për përmbarim të palës kreditore,ndërsa pas vazhdimit të kontestit të rregullt civil gjykata merr këtë;

### A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ndërmarrja N. PX Kosovë sh.p.k me seli në Prishtinë.

I.Detyrohet e paditura H.&R. C. me pronare I. K. që ti paguaj palës paditëse shumë e përgjithshme prej;2.781,23 euro,në emër të borxhit,me kamatë ligjore,si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës,duke filluar nga data 10.04.2011 e deri në pagesën definitive të borxhit,të gjitha këto në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.Detyrohet pala e paditur që ti paguaj shumë e përgjithshme prej;93,60 euro në emër të shpenzimeve e procedurës palës paditëse,nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

### A r s y e t i m

Pala Kreditore Ndërmarrja N. PX Kosovë sh.p.k me seli në P.,me datën;28.12.2012 ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përmbarimin lidhur me pagesën e borxhit në shumë e përgjithshme prej;2.781,23 euro,ndaj palëve debitore; N.H.T H.&R.C. me seli në fshatin H. e Q. me pronare I. K. dhe H. C.C me pronar Z. L.,duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e tij duke i detyruar palët debitore kryerjen e detyrimit ndaj palës kreditore,në afatin kohor prej shtatë ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Gjykata me rastin e pranimin të këtij propozimi ka lejuar të njëjtin me datën;31.12.2012 duke i njohtuar palët debitore lidhur me detyrimin e tyre që rrjedh nga ky propozim.Mirëpo pala debitore H. C. C. me pronar Z. L. në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtimin ndaj këtij propozimi duke kundërshtuar në tërësi thënjet e cekura të kreditorit në propozimin e tij për përmbarim,u thirrur në mungesën e legjitimitetit pasiv në këtë rast.

Pas pranimin të kundërshtimit të palës debitore kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore dhe pastaj edhe seancën e shqyrtimit kryesor duke shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit dhe duke vazhduar me zhvillimin e kontestit të rregullt civil bazuar në dispozitat e nenit 58 paragrafi 4 të LPK-së,në të cilat janë deklaruar edhe palët ndërgjyqëse duke i shprehur pretendimet e tyre lidhur me këtë çështje juridike.

Paraprakishtë pala paditëse me parashtresën e datës;08.07.2014 ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së dytë me pronar Z. L.,ndërsa ka mbetur në tërësi pranë pretendimeve të tija lidhur me të paditurën e parë H. C. me pronare I.K. Ndërsa në vazhdim të shqyrtimeve të mbajtura si dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata aprovimin e saj duke u bazuar konkretisht nga fatura e datës;24.07.2011 e deri në faturën e datës;12.04.2011 të cilat konsistojnë në shumën e përgjithshme të borxhit prej;2.781,23 euro në emër të porosisë së mallit e faturuar nga pala e paditur,të gjitha këto me kamatë ligjore prej 3.5 % duke filluar nga data 10.04.2011 e deri në pagesën definitive të borxhit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në propozimin për përmbarim.

E autorizuar e palës së paditur në pretendimet e saja e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë të palës paditëse,duke mbetur në tërësi pranë prapësimit të ushtruar ndaj propozimit për përmbarim të ushtruar nga pala kreditore,ndërsa lidhur me palën e paditur ka deklaruar se më të njëjtin nuk mundur të bie në kontakt,ndërsa në fund ka kërkuar nga gjykata refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka cekur.

Objekt shqyrtimi i kësaj çështje juridike ka qenë pagesa e shumës së përgjithshme prej;2.781,23 euro në emër të borxhit lidhur me pranimin e mallërave,sipas faturave që evidentohen data 12.04.2011 e deri në faturën e fundit e datës;24.07.2011.

Me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë gjykata paraprakishtë ka vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë duke u bazuar në faturat e pranuar duke filluar nga ajo e datës;12.04.2011 e deri tek fatura e datës;24.07.2011 në vlerë të përgjithshme prej;2.781,23 euro,andaj duke iu referuar dispozitës së nenit 262 të LMD-së ka vendosur ashtu si është cekur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në nenin 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës.

Gjykata pas shtjellimit të çështjes ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 262 të LMD-së, nenin 277 të LMD-së, si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

-Departamenti për Çështje Ekonomike-  
C.nr.88/2013, me dt;08.03.2016

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi

**UDHËZIME JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.